



## Procesverbali në dëgjimin publik në : Shirokë

Datë : 21.05.2026, 19:00

Pjesëmarrës nga Komuna:

1. Arta Gashi
2. Agim Bylykbashi
3. Shpresim Kuçi

Pjesëmarrës nga fshati: 6

M: 5

F: 1

- Nënkryetarja Arta Gashi përshëndet pjesëmarrësit dhe spjegon se çka janë dëgjimet publike.

- Agim Bylykbashi tregon për procedurat dhe prezanton buxhetin për vitin e ardhshëm si dhe ndarjen e mjeteve

- **Xhevat Baralia:** Ankohet se ka shumë qen endacak të cilët po i rrezikojnë nxënësit.
- Ankohet se parkingjet janë gjithmonë të okupuara nga persona që i lënë veturat e tyre me muaj. Kërkon që parkingjet të behen me pagesë.

- Agim Bylykbashi tregon se është e vertete që me qen endacak ka probleme në gjithë komunën dhe se jemi duke u munduar me eksperte që të bëjmë një zgjidhje por që komuna nuk ka shumë kompetenca në këto qeshtje dhe se po kemi pengesa nga organizatat e kafsheve.
- Për parking është ide që ti ofrohet për menaxhim shoqates së veteraneve të luftës dhe parkingjet të behen me pagese një shumë simbolike por që asgjë konkrete nuk ka deri më tani.

- **Ismet Suka:** Ankohet se autobusët ndalojnë pranë rrethrotullimit duke rrezikuar kembesoret si dhe bllokojnë trafikun. Gjithashtu se shoferët vozitjnë e bëjnë nën minimalen e shpejtësisë duke shkaktuar kolona. Propozon që të merren masa.

- Agim Bylykbashi tregon se nuk ka vendndalim aty dhe se do të bisedojë me drejtorinë e inspektionit që ti denojë kompanitë. Tregon se është shqetësuese kjo situatë.

- **Naim Lezi:** Pyet se çfarë projekte janë paraparë për fshat?
- Kërkon që rruga për të tregu i ri të bëhet me trotuar sepse rrezikohen kembesoret dhe madje ka pas edhe aksident me fatalitet.

- Agim Bylykbashi tregon se janë ndarë rreth 20.000 euro për sanime të rrugëve, mirembajtje të ndriqimeve publike etj.
- Gjithashtu tregon se do ndërtohet Kulla e Dëshmorit Besim Ndreca.
- Tregon se do mundohemi të rregullojmë trotuarin sa më shpejtë që të jete e mundur.

- **Sinan Palushi:** Te shtrohen kocka të parkingut para shkolles sepse pas çdo reshje nxënësit e kanë të vështirë të shkojnë në shkollë.
- Pengesa (polic të vdekur) në rrugën kryesore që lidhet me fshatin Sopije sepse shoferët vozisin shpejtë dhe rrezikohen kembesoret.
- Kërkon që të rregullohen rruget "Sadri Jakupi" dhe "2 Prilli" sepse janë rrugë që lidhen me rrugën kryesore dhe se ka familje që po e kanë problem të kyqen në shtëpitë e tyre sa herë ka

- Agim Bylykbashi tregon se si komune kemi pase shume problem me buxhet nga kontratat kolektive dhe se çështja e rruges se tij eshte e nderlikuar por pasi te formohet komisioni per vleresimin e degjimeve buxhetore do dalin ne teren dhe ta shikojne gjendjen.
- Per te shkolla do mundohemi ta rregullojme parkingun sa me shpejte.

• **Rexhep Shukolli:** Pyet se kush ka obligim pastrimin e varrezave?

- Agim Bylykbashi tregon se është kompetencë e kompanisë EkoTheranda por per momentin kemi pak staf dhe nuk po mund te ja dalim ti rregullojme te gjitha problemet me kohe por se jemi duke e fuqizuar kompanine lokale dhe se shpejt do shtohet numri i punetoreve.

- **Mihrie Suka:** Kerkon te behet sanimi i rr. "Pjetër Bogdani" sepse eshte demtuar shume dhe se shoferet duke tentuar tu ikin gropave vozisin ne trotuar dhe i rrezikojne kembesoret.
- Arta Gashi tregon se shume shpejte do te filloje sanimi i rrugeve ne gjithe komunen.

Procesmbajtës: Shpresim Kuqi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
OPSTINE SUVA REKA  
THE MUNICIPALITY OF SUHAREK



Lista e pjesëmarrësve në dëgjime publike në

Shirokë

Data: 21.05.2026

Nr	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1	Muharrem Suka	Shirokë	044 692 563
2	Ismet Suka	Shirokë	044 127
3	XHEVAT BARALIT	SHIROK	
4	NAIM LEZI	SHIROK	N-Lozi
5	<del>PERKAS DUKOJLI</del>	SHIROKË	
6	Sinan Jakushi	shirokë	Luqij
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			